



E DREJTA E
VIKTIMAVE PER
NDIHMË DHE
MBROJTJE
NGA DHUNA

Shtator 2013

LIGJET NË AUSTRI PËR
MBROJTJE NGA DHUNA

VIKTIMAT KANË TË DREJTË PËR MBROJTJE DHE NDIHMË!



LIGJET NË AUSTRI PËR MBOJTJE NGA DHUNA

Më 1. Maj të vitit 1997 në Austri hyri në fuqi Ligji shtetëror për mbrojtje nga dhuna në familje. Pas shumë ndryshimeve “Ligji për mbrojtje kundër dhunës”(2009), është përmirësuar për të ndihmuar dhe ruajtur viktimat. Amandamenti i fundit hyri në fuqi në vjeshtë të vitit 2013, dhe vendosi ndërmarrjen e masave lidhur me zgjerimin e mbrojtjes së fëmijëve të prekur nga dhuna. Ligjet përfshijnë mbrojtjen mbi të drejtën civile dhe atë policore, masat mbi të drejtën penale si dhe të drejtat e viktimës. Çdo person që qëndron në Austri duke mos marrë parasysh prejardhjen apo nënshtetësinë, ka të drejtë për mbrojtje nga dhuna.



MBROJTJA POLICORE NGA DHUNA

DENONCIMI DHE URDHËRI PËR DËBIM, SIPAS LIGJIT TË SIGURISË POLICORE § 38 A (SICHERHEITSPOLIZEIGESSETZ-SPG)
URDHËRI PËR DËBIM SIPAS LIGJIT TË SIGURISË POLICORE § 38 A (SICHERHEITSPOLIZEIGESSETZ-SPG)

Nëse në rrethin tuaj vuani ju apo fëmija i juaj dhunë trupore, psikike apo seksuale, ose edhe përndjekje (Stalking) e bezdisje të përsëritura, do të duhej t'ju drejtoheni ndonjë qendroje që ofron ndihmë (shiko adresat në faqen 12).

Nëse ju kërcënohet dhunë akute, do të duhej të lajmëroni menjëherë policinë (numrat e urgjencës janë 133 ose 122; këta numra mund t'i thirrni nga telefoni celular, edhe nëse nuk keni kredi të paguar – Guthaben).

Policia është e detyruar të ndërhyj shpejt në çdo rast të dhunës. Ajo ka për detyrë, që ta largoj (dëboj) menjëherë ushtruesin e dhunës (kundërvajtësin) nga vendbanimi, me qëllim që viktima të mund të qëndroj aty e mbrojtur.

KUJTI TAKON MBROJTJA SIPAS URDHËRIT PËR DËBIM (NDALIMIT TË HYRJES)?

Çdo person ka të drejtë të jetë i lirë nga dhuna në vendbanimin ku jeton, dhe secilit i takon mbrojtja ligjore.

SA ZGJAT NDALIMI PËR TU KTHYER NË VENDBANIM ?

Ndalimi për tu kthyer në vendbanim zgjat dy javë. Nëse do t'ju nevojitej mbrojtja edhe më tutje, do të duhej të bënit një kërkesë në gjykatën e qarkut

(Bezirksgericht) ku banoni, për një vendim gjyqësor (Antrag auf die Einstweilige Verfügung) me ç`rast dëbimi do të vazhdonte deri në katër javë. Më pas përmes vendimit gjyqësor, mund të ju takoj mbrojtja prej një kohe më të gjatë (shiko „Vendimit gjyqësor“ ne faqe 4).

A KANË RËNDËSI RAPORTET MBI PRONËSINË PËR DËBIM NGA VENDBANIMI

Fakti se kujt i takon banesa/shtëpia, nuk luan asnjë rol. Policia mund të largon çdo person që shkakton dhunë, e gjithashtu edhe pronarin.

PËR CILËN HAPËSIRË VLEN URDHËRI PËR DËBIM (NDALIMI I HYRJES) (EV)?

Urdhëri për dëbim vlen për banesë/ shtëpi, si dhe për rrethinën në afërsi të vendbanimit. Policia përcakton hapësirën e të mbrojturit dhe e paralajmëron personin që rrezikon viktimën.

MBROJTJA PËR FËMIJË DHE TË RINJ

Nëse fëmijët përfundi moshës 14 vjeçare janë të prekur nga dhuna, urdhëri për dëbim mund të shqiptohet edhe për shkolla dhe institucionet tjera, ku kërkohet kujdestaria ndaj fëmijëve. Kundërvajtësi (personi që rrezikon viktimën) duhet të mbaj distancë hapësirore prej pesëdhjetë metrash, në raport me objektet e ndaluara që i janë caktuar. Policia njofton kopshtin e fëmijëve (çerdhen), shkollën ose udhëheqësinë e qëndrimit ditor për këtë urdhër të ndalimit.

MARRJA E ÇELËSAVE

Policia duhet të merr menjëherë çelësat e vendbanimit, nga personi që shkakton rrezik (kundërvajtësi). Nëse është bërë paraprakisht kërkesa për një vendim gjyqësor (EV), policia detyrohet t`i dorëzon çelësat më tutje në gjykatën e qarkut.

ÇKA I LEJOHET PERSONIT TË LARGUAR TË MARR ME VETE?

Të larguarit(kundërvajtësit) i lejohe të marr në shpejtësi, vetëm gjërat e nevojshme personale (si p.sh. dokumentet e gjërat personale si dhe veshmbathjen).

ÇKA NDODH NËSE PERSONI QË SHKAKTON RREZIK NUK LARGOHET VULLNETARISHT?

Në këtë rast policia mund të zbatoj forcën e dhunës.

VIKTIMAT KANË TË DREJTË PËR MBROJTJE DHE NDIHMË!

A GUXON TË KTHEHET PERSONI I LARGUAR PËRSËRI NE VENDBANIM, PASI TË JETË QETËSUAR?

Jo.Përderisa qëndron urdhëri i dëbimit (ndalimi i hyrjes), personi i larguar nuk guxon të kthehet,sepse në këtë rast bëhet i ndëshkueshëm.

ÇKA NDODH NËSE KEQPËRDORET URDHËRI PËR DËBIM (NDALIMI I HYRJES)?

Nëse personi i larguar vjen në vendbanim apo në rrethinë, pavarësisht nga ndalimi i hyrjes, do të duhej të lajmëroni menjëherë policinë. Mospërfillja e ndalimit të hyrjes, ndëshkohet (deri në 500,-euro për çdo shkelje të ligjit). Në rastin e përsëritur, personi i dënuar (kundërvajtësi) do të mund të arrestohej.

A MUND TË SHFUQIZOHET (ANULOHET) URDHËRI PËR DËBIM (NDALIMI I I HYRJES) PARA PËRFUNDIMIT TË AFATIT DYJAVOR?

Ndalimi i hyrjes mund të anulohet vetëm nga autoritetet përgjegjëse.Kjo ndodh megjithatë, shumë rrallë. Në rast se shfuqizohet ndalimi i hyrjes,viktima duhet të njoftohet menjëherë.

A KONTROLLOHET MOSPËRFILLJA E URDHËRIT PËR DËBIM (NDALIMIN E HYRJES)?

Po. Respektimi i ndalimit të hyrjes do të kontrollohet, së paku një herë nga ana policore.

A ËSHTË I LIDHUR NDALIMI I HYRJES ME NDËRMARRJEN E MASAVE POLICORE NË VENDIN E NGJARJES?

Jo. Këto masa mund të ndërmerren edhe në rastet kur viktima lajmëron policinë, sepse ajo vazhdon të ketë frikë nga ndonjë dhunë e ardhshme,edhe pse ka lajmëruar rastin e parë të ndodhjes.

INFORMATAT DHE DOKUMENTET E OBLIGUARA

Policia duhet t'i dorëzoj viktimës një letër informimi,përmes së cilës do të informohej mbi mundësinë e parashtimit të kërkesës për një vendim gjyqësor.Edhe kundërvajtësi i dorëzohet një letër informimi. Kjo përmban informatën: se mospërfillja për ndalimin e hyrjes ndëshkohet, si dhe informatën mbi mundësinë e strehimit.

Policia duhet të dokumentoj saktë, çdo akt të dhunës në familje dhe në rast se kërkohet një vendim gjyqësor, ta paraqes raportin e përgatitur në gjykatë.

KËSHILLA DHE PËRCJELLJE (PA PAGESË) NË QENDRAT INTERVENUESE DHE ATO PËR MBROJTJE NGA DHUNA

Në rast të një lëshimi të urdhërit për dëbim duhet të lajmëroheni nga qendrat e intervenimit, si dhe ato për mbrojtje nga dhuna në krahinën tuaj, të cilat ofrojnë këshilla dhe përcjellje pa pagesë (falas).



MBROJTJA AFATGJATE PËRMES VENDIMIT GJYQËSOR (EINSTWEILIGE VERFÜGUNG – EV) SIPAS NENIT § 382B DHE TË RREGULLORES EKZEKUTIVE

ME RËNDËSI! Ndalimi policor për hyrje zgjat dy javë. Nëse dëshironi të vazhdoni zgjatjen për mbrojtje, duhet brenda këtyre dy javëve të bëni kërkesën për një vendim të së Drejtës Civile (EV). Një kërkesë për një vendim gjyqësor, mund të shtrohet edhe pa ndërhyrje të mëparshme të policisë.

Është shumë me rëndësi, që të këshilloheni para se të bëhet kërkesa për këtë vendim (EV). Qendrat e intervenimit dhe të mbrojtjes nga dhuna ju ofrojnë këshilla, ju ndihmojnë gjatë parashtrimit të kërkesës, dhe ju përcjellin si person i besuar gjatë seancave gjyqësore. Gjithashtu edhe shtëpitë e grave dhe qendrat këshilluese të grave, mund t ju përkrahin gjatë parashtrimit të kërkesës.

KU DHE SI MUND TË BËHET NJË KËRKESË PËR VENDIM GJYQËSOR (EV)?

Vendimi gjyqësor mund të bëhet në gjykatën e qarkut (Bezirksgericht) të vendbanimit tuaj. Ju mund të parashtroni kërkesë me shkrim, apo edhe gojarisht gjatë ditëve zyrtare në gjyq. Në raste urgjente, duhet që kërkesa të merret parasysh edhe ditëve tjera.

PËR ÇFARË RASTE MUND TË PARASHTROHET NJË VENDIM I GJYQËSOR (EV)?

Kërkesa për këtë vendim (EV) mund të parashtrohet nëse për arsye të ndonjë dhunë fizike apo kërcënimi të këtij lloji, jeta e përbashkët si dhe takimi me personin që ushtron dhunë, bëhet e pamundur. Edhe gjatë keqtrajtimit psikik, mund të kërkohet ky vendim (EV), nëse përmes tij dëmtohet rëndë shëndeti psikik i viktimës.

VIKTIMAT KANË TË DREJTË PËR MBROJTJE DHE NDIHMË!

KUSH E FITON MBROJTJEN GJATË NJË VENDIMI GJYQËSOR (EV)?

Të gjithë ata të cilët pësojnë dhunë në rrethinën ku banojnë, ose edhe në jetën e tyre personale p.sh. nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, partneri ose ish-partneri, apo edhe nga babai ose nga ndonjë person tjetër. Raporti familjar me personin që shkakton rrezik, nuk qëndron si kusht në këtë rast.

MBROJTJA PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË

Ligjet mbrojnë edhe fëmijët dhe të rinjtë të cilët keqtrajtohen në mënyrë direkte ose edhe indirekte, dhe janë të tronditur si p.sh. gjatë përjetimit të dhunës që ushtrohet në nënën e tyre (dhunë psikike). Në këtë rast e ëma si përfaqësuese ligjore, mund të parashtroj kërkesën për një vendim gjyqësor (EV). Të njejtën gjë mund ta bëjë edhe enti për kujdesin e të rinjëve (Jugendamt), me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve si dhe të së drejtës për qëndrimin e sigurtë të tyre në vendbanim.

PËR CILAT FUSHA (RRETHANA) MUND TË PARASHTROHET KËRKESA PËR MBROJTJE?

Mbrojtja përfshin disa fusha:

1. Mbrojtja në rrethinën e vendbanimit (sipas Ligjit § 382 b të rregullores Ekzekutive EO)

Nëse në vendbanimin tuaj përjetoni dhunë nga personi me të cilin bashkëjetoni (p.sh. nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, i ati, bashkëbanuesi,....), mundeni të kërkonin nga Gjykata e Qarkut (Bezirksgericht) që personi i cili ushtron dhunë, të braktis banesën/shtëpinë dhe të mos kthehet në rrethinën e vendbanimit.

A luajnë ndonjë rol raportet e pronës apo qirasë?

Jo, për një vendim gjyqësor (EV), vendimtare është dhuna e assesit pronësia. Personi i dhunshëm mund të dëbohet nga vendbanimi, edhe nëse është pronar i banesës/shtëpisë.

Sa zgjat vendimi gjyqësor (EV) për vendbanim?

Ky vendim i cili miratohet nga gjykata mund të zgjas 6 muaj. Nëse brenda këtyre 6 muajve shtrohet lutja për shkurorezim apo për ndonjë procedurë tjetër, si p.sh. për sqarimin e të drejtës së shfrytëzimit të vendbanimit, atëherë ky vendim vlen deri në fund të kësaj procedure.

2. Mbrojtja e përgjithshme nga dhuna (sipas Ligjit § 382 e të rregullores Ekzekutive- EO)

Në të njëjtën kohë me mbrojtjen në vendbanim, mund të kërkohet nga gjykata, që personit, i cili shkakton rrezik t'i ndaloheq qëndrimi në vende të caktuara (si p.sh. në vendin e punës, në shkollë, në kopshtin e fëmijëve) si dhe t'i ndërpritet çdo kontakt (personal, telefonik,përmes e-mail-it,etj. . . .) me viktimën.

Vendimi gjyqësor(EV) për mbrojtje në vende të caktuara si dhe ndalimi i kontaktit me personin e dhunshëm, mund të kërkohet pavarësisht nga vendimi gjyqësor për mbrojtje në vendbanim.

SA ZGJAT KY VENDIM (EV)?

Një vendim i tillë për mbrojtje nga dhuna në vende të ndryshme, mund të miratohet nga gjykata për 1 vit zgjatjeje. Nëse vazhdon dhuna edhe më tutje, mund të kërkohet vazhdimi i zgjatjes së këtij vendimi.

SI DO TË DUHEJ TË VËRTETOHEJ DHUNA?

Për vërtetimin e dhunës (qoftë ajo fizike, kërcënim me dhunë ose edhe dhunë psikike, që e dëmton rëndë shëndetin) duhet të dëshmoheq në gjykatë me të ashtuquajtura „Mjete dëshmuese“ (Bescheinigungsmittel).Këtu llogariten p.sh. deklarata e viktimës, raportet nga policia, deklaratat nga dëshmitarët, analizat e spitalit me dëshmitë e mjekut, vendimet e gjykatës mjekësore, raportet e psikologëve,terapeuteve dhe bashkëpunëtorëve nga qendrat ndihmëse, fotografitë, etj.Kurse raportet policore kërkohen drejtpërdrejtë nga gjykata.

SA SHPEJT VENDOS GJYQI PËR KËRKESËN (MERR VENDIMIN)

Gjyqi duhet të vendosë mundësisht shumë shpejt dhe te merr vendimin (EV). Në rast se ekziston ndonjë urdhër policor per ndalim hyrjeje, vendimi duhet të sillet për 4 javë, nëse brenda 2 javëve të para është shtruar kërkesa për një ndalim të tillë.Gjykata duhet te vendosë brenda këtyre 4 javëve, me qëllim që të mos ketë ndërprerje në mbrojtje.

A DUHET TË MERRRET NË PYETJE KUNDËRVAJTËSI NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR VENDIMIN GJYQËSOR (EV)?

Jo, ky vendim(EV) mund të miratohet edhe pa dëgjimin e personit që shkakton rrezik (kundërvajtësit), sepse bëhet fjalë për ndërmarrjen e masave te mbrojtjes. Në raste normale gjyqi i jep mundësi për dëgjim edhe kundërvajtësit.

VIKTIMAT KANË TË DREJTË PËR MBROJTJE DHE NDIHMË!

ME RËNDËSI! Me qëllim që të fuqizohet dhe aprovohet vendimi gjyqësor (EV), duhet kërkuar që vendimi të fillon të zbatohet menjëherë, në mënyrë që të mund të informoheni me kohë për përmbartimin e tij si dhe të autorizohet policia për zbatimin e vendimit të marrë.

SI ZBATOHET VENDIMI GJYQËSORË ?

Nëse gjyqi e miraton vendimin (EV), ju si parashtruese e kërkesës duhet të informoheni, se kur do të zbatohet vendimi. Nëse në bazë të vendimit gjyqësor, kundërvajtësi do të duhej të largohej nga vendbanimi, juve ju mbetet të vendosni a pajtoheni të jeni prezent apo jo. Zbatimi pason përmes ekzekutuesit gjyqësor (Gerichtsvollzieher). Në raste urgjente dhe të rrezikshme, gjykata mund të kërkoj edhe nga policia për zbatimin e vendimit, ashtuqë dëbimi nga vendbanimi do të pasonte përmes policisë.

ÇKA MUND TË NDODHË GJATË ZBATIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR?

Ekzekutuesi gjyqësor, gjegjësisht policia ia dorëzon vendimin kundërvajtësit dhe e urdhëron që menjëherë ta lëshoj (braktis) vendbanimin. Ai duhet t'i dorëzoj të gjitha çelësat e vendbanimit, të cilat do të mbesin në gjykatë. Nëse në ndërkohë kundërvajtësi është dëbuar nga ana policore, atij do t'i dërgohet vendimi gjyqësor në adresën që e ka dhënë në stacionin policor. Nëse ai nuk ka dhënë kurrfarë adrese, atëherë vendimi do të depozitohet në gjykatë dhe do të sherbejë si i vlefshëm.

ÇKA I LEJOHET TË MARR ME VETE?

Personi që shkakton rrezik (kundërvajtësi), ka të drejtë t'i marr me vete vetëm gjërat e tij personale, dhe vetëm nën përcjellje të zbatuesit gjyqësor ose policor. Ndër gjërat personale hyjnë p.sh.: dokumentet personale, veshmbathja personale si dhe pajisjet e punës. Gjërat që i përkasin familjes si: pajisjet shtëpiake, kursimet dhe gjërat me vlerë, nuk i lejohen t'i marr me vete. Për ndarjen e këtyre gjërave në rast mosmarreveshjeje, vendos gjykata civile.

ÇFARË MUND TË BËJ NË QOFTË SE PERSONI I NDALUAR NUK VEPRON NË PËRPUTHJE ME VENDIMIN GJYQËSOR (EV)?

Në këtë rast, do të duhej që menjëherë të njoftoni policinë. Policia duhet t'ju sigurojë, që personi i ndaluar të braktis vendet në të cilat ai nuk guxon të qëndroj. Policisë i lejohet të përdor edhe dhunën (forcën detyruese).

Mospërfillja e vendimit gjyqësor (EV) është një shkelje administrative, e cila do të dënohet me një gjobë deri në €500. Në raste të mospagesës dënimi është: qëndrimi në burg deri në dy javë. Pas ndërhyrjes së tyre, policia duhet të dërgon në gjykatë një raport për shkelje të vendimit gjyqësor (EV).

SHPENZIMET, NDIHMAT RRETH PROCEDURËS DHE PËRKTHIMEVE

Në rastin kur të ardhurat materiale janë të ulëta, mund të bëhet kërkesa për ndihmë rreth procedurës (Verfahrenshilfe) në gjykatë. Kërkesa parashtrohet duke plotësuar një formular, i cili gjendet në gjykatë. Në ndihma procedurale mund të përfshihen: heqja e shpenzimeve gjyqësore, shpenzimet shtesë për një avokat / avokate, apo shpenzimet për një përkthyes (në rastin e dhunës, gjyqi duhet të kërkoj për përkthyes një femër). Që nga 1. Qershori i vitit 2009, viktimat kanë gjithashtu të drejtë për përkrahje gjatë proceseve psikike-sociale në procedurën civile (shiko pjesën „Përcjellja e procesit“).



AKTET E DHUNËS SIPAS KODIT PENAL AUSTRIAK

Kodi Penal austriak përmban një listë me akte të dhunshme, të cilat konsiderohen si vepra që duhet të dënohen. Përpos tjerave këtu përfshihen:

- Lëndimet trupore dhe lëndimet e rënda trupore (Kodi Penal Austriak-StGB §§ 83 dhe 84)
- Lëndimet e rënda trupore me qëllim të caktuar (§ 87)
- Paraburgimi (§ 99)
- Trafikimi i qenieve njerëzore (§ 104 a)
- Detyrimi dhe detyrimi i rëndë (§§ 105 dhe 106)
- Kërcënimi i rrezikshëm (§ 107)
- Ndjekja e vazhdueshme (Stalking) (§ 107 a)
- Ushtrimi i vazhdueshëm i dhunës (§ 107 b)
- Përdhunimi (§ 201)
- Sulmi seksual (§ 202)
- Abuzimi i rëndë seksual dhe abuzimi seksual ndaj të miturve (§§ 206 dhe 207)

Të gjitha aktet e dhunës janë të ashtuquajtura akte zyrtare, që do të thotë, ato do të ndiqen dhe do të akuzohen penalisht nga shteti, sapo të jenë të njohura nga organet e shtetit (policia, gjykata). Pëlqimi i viktimës nuk është i nevojshëm.

VIKTIMAT KANË TË DREJTË PËR MBROJTJE DHE NDIHMË!

Më 1. Qershor 2009, të Drejtës Penale në Austri ju shtua edhe një akt i ri për kundërvajtje, „Dhuna e vazhdueshme“ (107b StGB). Dhuna e përsëritur mbi një person është shkelje e ligjit, dhe do të dënohet më shumë se sa rastet individuale të dhunës.



MBROJTJA NGA NDJEKJA E VAZHDUESHME (STALKING)

Stalking është definuar si dënim në Kodin penal Austriak që nga 1. Qershori i vitit 2009, nën konceptin „Ndjekje e vazhdueshme“ (§ 107a StGB).

ÇKA NËNKUPTOHET ME STALKING?

Stalking është një situatë, në të cilën një person ndjek një person tjetër kundër vullnetit të tij, për një periudhë të gjatë dhe në këtë mënyrë personit të përndjekur i dëmtohet dhe kufizohet mënyra e jetesës së tij. Këtu përfshihen p.sh. ndjekja e përsëritur, bezdisja përmes thirrjeve telefonike, përmes e-mailit apo dhe mënyrat tjera. Gjithashtu kërkesa e përdorimit të të dhënave të një personi, apo kontaktimi me viktimën përmes një personi të tretë, është akt që dënohet.

ÇKA MUND TË NDËRMARR KUNDËR STALKING-UT?

Ju duhet patjetër të njoftoni policinë dhe të bëni një ankesë. Në raste urgjente duhet të thirrni menjëherë policinë. Policia mund ta shqiptoj ndalimin e hyrjes për ndjekësin (Stalker) (§ 38a Ligji për sigurinë policore).

VENDIMI GJYQËSOR KUNDËR STALKING-UT

(sipas § 382G të Rregullores së Ekzekutimit)

Për mbrojtje të menjëhershme nga përndjekja e vazhdueshme, ju mund të kërkonte një vendim gjyqësor. Kërkesa parashtrohet në gjykatën e qarkut ku banon viktimja. Kërkesa mund të bëhet për masat e mëposhtme:

- Ndalimi i kontaktit personal dhe përndjekja,
- Ndalimi i kontaktit në të shkruar, telefonik apo kontakteve tjera,
- Ndalimi i qëndrimit në vende të caktuara,
- Ndalimi i shpërndarjes së mëtuqeshme të të dhënave personale dhe fotografive,
- Ndalimi i porosisë së mallrave apo shërbimeve tjera, duke përdorur të dhënat personale të viktimës,
- Ndalimi i kontaktit me viktimën përmes një personi të tretë.

Vendimi gjyqësor (EV) kundër Stalking-ut mund të zbatohet nga policia. Megjithatë për këtë duhet bërë kërkesa në mënyrë të qartë. Në raste të mospërfilljes së vendimit gjyqësor (EV), duhet që menjëherë të njoftoni policinë, si dhe të bëni kërkesën në gjyq për ta dënuar të akuzuarin (shiko gjithashtu „Zbatimi i vendimit gjyqësor EV, faqe 7).



TË DREJTAT E VIKTIMËS

Viktimat që pësojnë vepra penale kanë të drejta të caktuara gjate procedimit penal, të cilat janë të përcaktuara në Kodin e procedurës penale (StPO 4. Pjesa kryesore §§ 65–73). Këtu përfshihen, si për shembull e drejta për:

- Informimin mbi procedurën,
- Informimin për lirimin e personit të dhunshëm nga paraburgimi,
- Pasqyrën në dosjen e gjykatës ,
- Marrjen në pyetje në mënyrë të kujdesshme dhe trajtimin me respekt,
- Pjesëmarrjen dhe përfshirjen në procedurë,
- Kompensimin e dëmeve materiale dhe të hollave për dhimbjet e shkaktuara (Schmerzensgeld)
- Përcjelljen gjatë procesit.

E drejta për marrjen në pyetje në mënyrë të kujdesshme garanton, që viktima të mos dëshmon në prani të personit të dënuar (kundërvajtësit). Ekziston mundësia që viktima të pyetet dhe dëgjohet në dhomë të veçantë, dhe e gjithë kjo të transmetohet përmes videos në sallën e gjyqit. Fëmijët duhet të merren në pyetje gjithmonë me kujdes, dhe atë nga ekspertët. Edhe ata persona të cilët janë lënduar në integritetin e tyre seksual, kanë të drejtë për këtë lloj dëgjimi. Këtë mënyrë të dëgjimit, kanë të drejtë ta kërkojnë të gjitha viktimat tjera me kërcënim dhune. Me qëllim që viktimat të kursehen, nga deklaratat shpeshherë të vështira gjatë seancës kryesore, mund të bëhet gjithashtu kërkesa që dëgjimi i dëshmitëve (nga ana e viktimit) të bëhet më herët (intervistë kontradiktore).

Që nga 1. Qershor 2009, viktimat në rrethana të caktuara kanë të drejtë për dëgjim të kujdesshëm. Ato më tutje, kanë të drejtë ta mbajnë të fshehtë, adresën e vendbanimit nga personi i ndaluar (kundërvajtësi).

VIKTIMAT KANË TË DREJTË PËR MBROJTJE DHE NDIHMË!

E DREJTA PËR PËRCJELLJE(SHOQËRIM) GJATË PROCESIT (SIPAS LIGJIT TË PROCEDURËS PENALE §§ 66 DHE LIGJIT TË PROCEDURËS CIVILE § 73B)

Me qëllim që të mbrojnë të drejtat e tyre, viktimat nga dhuna kanë të drejtë në përcjellje psikike-sociale si dhe përcjellje juridike të procedurës në procedimin penal.

SI MUND TË FITOHET E DREJTA PËR PËRCJELLJE GJATË PROCESIT?

Aprovimi për të drejtën e përcjelljes, bëhet shpejt dhe në mënyrë jobyokratike. Ministria shtetërore e drejtësisë, ka autorizuar qendrat për mbrojtjen e viktimave në të gjitha krahinat regjionale(Bundesländern), që ta marrin përsipër përcjelljen e viktimave në proceset e tyre. Nëse jeni të prekur nga dhuna, mund të lajmëroheni në këto qendra, ku do t'iu jipet edhe përcjellja. Qendrat e intervenimit dhe ato për mbrojtje nga dhuna, ju ofrojnë këtë lloj përcjelljeje në të gjitha krahinat regjionale (shiko adresat në faqe 12).

ÇKA PËRFSHIN PËRCJELLJA GJATË PROCESIT ?

Përcjellja psikike-sociale përfshin si p.sh., përcjelljen deri në stacionin policor me qëllim të paraqitjes së ankesës, informimin dhe përgatitjen për procedurën penale dhe përcjelljen gjatë dëgjimit në seancën kryesore. Përcjellja gjate procesit juridik përfshin, përfaqësimin ligjor në procedurën penale nga një avokat / avokate, për të mbrojtur të gjitha të drejtat dhe kërkesat e viktimës.

Që nga 1. Qershori i vitit 2009, viktimat të cilat në procedurë penale fitojnë përcjelljen psikike-sociale gjatë procesit, mund ta fitojnë të njëjtën mbështetje edhe në procedurë civile.

Si kusht nevojitet që, procesi të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me procedurën penale (si p.sh. procedura e shkurorëzimit, procedura për zbatimin e vendimit gjyqësor, procedura e kujdestarisë).

Në procedurat civile, viktimat nuk kanë të drejtë për përcjellje juridike (të avokatëve) pa pagesë (falas). Në kuadër të ndihmës procedurale, mund të kërkohet një avokat/avokate (i/e cili/a do të ishte falas).



QENDRAT QË OFROJNË NDIHMËNË AUSTRI

FRAUENHELPLEIN 0800/222 555, thirrja pa pagesë në 24 orë

GEWALTSSCHUTZZENTREN / INTERVENTIONSSTELLEN GEGEN GEWALT (QENDRAT PËR MBROJTJE NGA DHUNA / ENTET PËR INTERVENIM KUNDËR DHUNËS)

BURGENLAND	03352 / 314 20
KÄRNTEN	0463 / 590 290
NÖ / ST. PÖLTEN	02742 / 319 66
NÖ / WR. NEUSTADT	02622 / 243 00
NÖ / ZWETTL	02822 / 530 03
NÖ / AMSTETTEN	02742 / 31 966
OBERÖSTERREICH	0732 / 607 760
SALZBURG	0662 / 870 100
STEIERMARK	0316 / 774 199
TIROL	0512 / 571 313
VORARLBERG	0517 / 55 535
WIEN	01 / 585 32 88

INTERVENTIONSSTELLE FÜR BETROFFENE DES FRAUENHANDELS (QENDRAT E INTERVENIMIT PËR GRATË E PREKURA NGA TRAFIKIMI I GRAVE)

LEFÖ-IBF	01 / 796 92 98
----------	----------------

FRAUENHÄUSER (STREHIMORET/SHTËPITË E SIGURTA PËR GRA)

AMSTETTEN	07472 / 665 00
BURGENLAND	02682 / 612 80
DORNBIRN	0517 / 55 577
GRAZ	0316 / 42 99 00
HALLEIN	06245 / 80 261
INNSBRUCK	0512 / 580 977



QENDRAT QË OFROJNË NDIHMËNË AUSTRI

FRAUENHÄUSER (STREHIMORET / SHTËPITË E SIGURTA TË GRAVE)

INNVIERTEL	07752 / 717 33
KAPFENBERG	03862 / 279 99
KLAGENFURT	0463 / 449 66
KUFSTEIN	05372 / 636 16
LIENZ	04852 / 671 93
LINZ	0732 / 606 700
LAVANTTAL	04352 / 369 29
MISTELBACH	02572 / 50 88
MÖDLING	02236 / 465 49
NEUNKIRCHEN	02635 / 689 71
PINZGAU	0664 / 500 68 68
SALZBURG	0662 / 458 458
SPITAL / DRAU	04762 / 61 386
STEYER	07252 / 877 00
ST. PÖLTEN	02742 / 366 514
TIROL	0512 / 342 112
VILLACH	04242 / 31 0 31
VÖCKLABRUCK	07672 / 22 7 22
WELS	07242 / 678 51
WIEN Frauenhaus-Notruf	05 77 22
WR. NEUSTADT	02622 / 88066

QENDRAT KËSHILLUESE (BERATUNGSSTELLEN) KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

KAPFENBERG	03862 / 279 99
ST. PÖLTEN	02742 / 366 514
VÖCKLABRUCK	07672 / 227 22
WELS	07242 / 452 93
WIEN	01 / 512 38 39
WR. NEUSTADT	02622 / 825 96

IMPRESSUM (BOTUAR NGA:)

WIENER INTERVENTIONSSTELLE GEGEN GEWALT IN DER FAMILIE

1070 Wien, Neubaugasse 1/3, Tel.:01 / 585 32 88, Fax:01 / 585 32 88-20
office@interventionsstelle-wien.at, www.interventionsstelle-wien.at

VEREIN AUTONOME ÖSTERREICHISCHE FRAUENHÄUSER

Informationsstelle gegen Gewalt, 1050 Wien, Bacherplatz 10 / 4, Tel.: 01/544 08 20,
Fax: 01/544 08 20-24. informationsstelle@aoef.at, www.aoef.at

TEKSTI: Rosa Logar; **PËRGADITJA TEKNIKE:** Leocadia Rump dhe Vlado Kalajdzic

BOTIMI: Berger, 3580 Horn

Gefördert aus Mitteln des BM für Gesundheit und Frauen, des BM für Inneres und des BM für Justiz

5. Auflage: März 2017



**MINISTERIUM
FRAUEN
GESUNDHEIT**

FRAUENHÄUSER



REPUBLIK ÖSTERREICH
BUNDESMINISTERIUM FÜR INNERES



VINI RE! KENI KUJDES PËR SIGURINË TUAJ!

Urdhëri për dëbim(ndalim hyrjeje) si dhe miratimi i përkohshëm, ofrojnë për viktime: mbrojtje dhe mundësi që të mbesin në mjedisin e njohur për ta. Këto masa nuk janë mbrojtje e plotë nga dhuna! Në situata të rrezikshme ju këshillojmë që, bashkë me fëmijët tuaj ta braktisni vendbanimin dhe të kërkonj një strehim të sigurtë (si p.sh. në shtëpi të sigurta të grave), e edhe në rastet kur personi që shkakton rrezik(kundërvajtësi) është debuar nga ana policore.

Rreziku nga dhuna rritet sidomos gjatë kohës së ndarjes dhe shkurorëzimit!

Shkaqe të tjera, të cilat flasin për një rritje të rrezikut nga kundërvajtësi janë: ushtrimi i përsëritur i dhunës, posedimi i armës, kërcënimet e rrezikshme, keqpërdorimi i alkoholit dhe drogës, xhelozia e sëmurë dhe mendimi për posedim, besimi rigoroz mbi nderin, gatishmëria për çfarëdo lloj dhune, papunësia, dhuna ndaj fëmijëve e veçanërisht ndaj fëmijëve të pranuar(të burrit ose të gruas).

Prandaj është shumë e rëndësishme, që të kujdeseni për sigurinë tuaj, e sidomos nëse planifikoni një ndarje. Në aso raste, do të duhej që të kërkonj patjetër ndihmë profesionale, në mënyrë që të ndërtonj rrejtë më të gjerë për mbështetje (shiko faqen 12: adresat e qendrave që ofrojnë ndihmë).

FRAUENHELPLINE 0800 / 222 555
THIRRJA PA PAGESË NË 24 ORË

NUMRI URGJENT I POLICISË
133 ose 112